



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

No. 32      Dt. 13.02.2017

**“PËR MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJE PUS -SHPIMI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formulatëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin – Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe opinionit të DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë:

V e n d o s i :

- 1- Miratimin e lejes për hapje pus- shpimi në zonën e Koplikut, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, Z. Maria PLLOMBI, për ujtime në bujqësi.  
Sipas studimit të paraqitur nga subjekti pusit i shpimit do të ketë këto të dhëna:  
Koordinatat e pusit të shpimit:    K – 45 78 221,46    Y – 43 70 297    Z – 82  
Thellësia e pusit: 230 m - 250 m  
Prurja e pusit: 2- 2,5 l sek
- 2- Në zbatim të nenit 56 pika 3 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” subjekti i punës duhet që në një muaj pas përfundimit të shpimit duhet të paraqesë pranë ABU Drin- Bunë një raport të hollësishëm hidrologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e formacioneve të sipërta, si dhe gjatë dokumentacionin përkatës.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

